



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
Trajtimin ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202301117/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** *Rekomandime për inspektimin e kryer në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisaratin e Policisë Tropojë.*

**Drejtuar:** Drejtues Artan BAJRAKTARI  
Drejtoria Vendore e Policisë Kukës

KUKËS

Kryekomisar Përparim ALLMUÇA  
Komisariati i Policisë Tropojë

BAJRAM CURRI

*I nderuar z.Bajraktari,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, më lejoni të vlerësoj angazhimin tuaj dhe institucionit që ju drejtoni, në mbrojtjen dhe garantimin e lirive e të drejtave të personave që ju privohet liria në mjediset e Policisë së Shtetit.

Në vijim, po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi që institucioni i Avokatit të Popullit, zhvilloi në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisaratin e Policisë Tropojë. Inspektimi u zhvillua në datë 24.11.2023 nga grupi i punës i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit të inspektimit morën pjesë z.Besnik Deda dhe z.Hazbi Selita me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i vizitës inspektuese ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar

në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre” miratuar me Urdhër nr.1720, datë 20.11. 2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe procedurën standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” miratuar me Urdhër nr.894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Aspekt tjetër i vizitës inspektuese, ishte dhe verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm<sup>1</sup>.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, sa më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Sipas metodologjisë të zhvillimit të inspektimit në strukturat vendore të policisë, ku mbahen e trajtohen shtetas të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, grupi i punës u takua me shefin e sektorit të krimeve z.Klodian Qerimi dhe shefin e sektorit të rendit z.Genc Reçi të Komisarariatit të Policisë Tropojë, në mungesë të shefit të komisarariatit, të cilët u vunë në dijeni në lidhje me qëllimin e inspektimit.

Grupi i inspektimit mori informacion për masat e marra për plotësimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm, në lidhje me krijimin e kushteve infrastrukturore në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë të komisarariatit, bazuar në kriteret e përcaktuara në procedurën e punës dhe standardet ndërkombëtare për këtë qëllim. Plotësimi i këtyre kushteve, përbëjnë një garanci për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, gjatë qëndrimit në mjediset e këtij komisarati.

Nga informacioni i drejtuesve të komisarariatit, si dhe nga verifikimi në vend i zbatimit të rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm, rezultoi se:

- ✓ **Ishte realizuar** rekomandimi për krijimin më vehte të ambientit të shoqërimit, në mjediset e godinës kryesore të komisarariatit.

Ndërkohë, nga informacioni rezultoi se disa nga rekomandimet **nuk ishin plotësuar** me argumentin se, komisarati nuk ka fonde të planifikuara në buxhet, për kryerjen e investimeve dhe konkretisht:

- ✓ Dhomat e shoqërimit **nuk** ishin të pajisura me orëditë e nevojshme (tavolinë pune dhe stola për qëndrimin ulur të personave), sipas normave dhe parametrave teknikë për ndërtimin e dhomave të shoqërimit.
- ✓ Ambienti i shoqërimit **nuk** ishte i monitoruar nga sistemi i kamerave audio-vizive.

---

<sup>1</sup> Me shkresë nr.K4/I33-2 prot., datë 28.07.2022 dërgohet “Rekomandimi i institucionit të Avokatit të Popullit për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Tropojë”.

- ✓ Në ambientin e shoqërimit **nuk** kishte dhomë (zyrë) më vehte për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të shoqëruar në konflikt me ligjin, para se ata të dërgohen në ambientin e sigurisë.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm, vijoi me inspektimin e ambientit të shoqërimit dhe të sigurisë, kontrolloi dokumentacionin dhe regjistrat ku pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, si dhe vizitoi zyrat e punonjësve të policisë që kryejnë veprime procedurale me këta persona.

Vlen të theksojmë se, drejtuesit e komisariatit dhe punonjësit e policisë u treguan bashkëpunues dhe transparentë me grupin e inspektimit, gjatë komunikimit, si dhe kryerjes së inspektimit në ambientet e këtij komisariati.

### **Ambienti i shoqërimit dhe kushtet e tij**

Ambienti i shoqërimit në Komisaratin e Policisë Tropojë, **nuk** ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe procedurën standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, ku përcaktohet qartë se, *“Personat e shoqëruar mbahen në mjedise e ambiente me kushte të ndryshme nga ato që shërbejnë për mbajtjen e personave të arrestuar/ndaluar (dhomat e sigurisë)...Mjediset/ambientet të jenë të ndara më vehte për persona të rritur, femra dhe të mitur”<sup>2</sup>.*

Mjedisi i shoqërimit ishte krijuar i ri dhe kishte filluar të funksionojë në muajin Tetor 2022, duke përshtatur 2 (dy) dhoma shoqërimi (një dhomë për burra dhe një dhomë e përbashkët për gra/të mitur), si dhe një ambient që shërben për tualet. Ambienti ndodhej në katin e parë të godinës të komisariatit, por me dalje më vehte.

Sipërfaqja e dhomave të shoqërimit është 4x5m secila (20 m<sup>2</sup>), me hapësirë të bollshme për qëndrimin e personave. Dritaret e dhomave të shoqërimit janë me përmasa të tilla që të krijojnë mundësi për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral. Në pjesën e jashtme të dritareve, janë të vendosura zgara hekuri, për sigurimin fizik të personave që qëndrojnë në këto dhoma. Në momentin e inspektimit, dhomat ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare.

Gjatë inspektimit u evidentua se, dhomat e shoqërimit **nuk** ishin të plotësuara me orënditë e nevojshme si tavolina pune për specialistët e policisë dhe stola për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar.

Pranë dhomave të shoqërimit ishte ndërtuar dhe funksiononte një tualet i përbashkët për gra dhe burra, për kryerje të nevojave personale, me sipërfaqe që mundësonte vendosjen e pajisjeve hidro-sanitare.

Dyert e dhomave të shoqërimit janë metalike dhe mbyllen nga jashtë me bravë hekuri dhe me çelës. Në kushtet që janë të vendosura, dyert metalike **nuk** plotësojnë normat dhe

---

<sup>2</sup> Kreu VII, pika 4/b e procedurës standarde.

standardet që përcaktohen në procedurën standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”<sup>3</sup>.

Rrjeti i ndriçimit elektrik në dhomat e shoqërimit funksiononte në rregull dhe furnizohej nga rrjeti elektrik i institucionit. Komandimi i ndriçimit bëhej nga korridori i dhomave të shoqërimit me çelës.

Në korridor dhe në dhomat e shoqërimit, **nuk** ishin të afishuara postera me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë së shtetit. Mungesa e posterave përbën shkelje të së drejtës të personave të shoqëruar, për t’u informuar në çdo kohë me të drejtat e tyre gjatë qëndrimit në mjediset e Policisë së Shtetit. Shkelja e të drejtës për informim që gëzojnë personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar në mjediset e Policisë së Shtetit, është konstatuar edhe nga KPT (CPT) gjatë vizitës inspektuese në Shqipëri në vitin 2018, duke rekomanduar që të drejtat e personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar në mjediset e policisë duhet të afishohen në vende të aksesueshme prej tyre, si dhe ata duhet të informohen me të drejtat që nga fillimi i privimit të lirisë<sup>4</sup>. Në vlerësimin e Avokatit të Popullit ky rekomandim nënkupton se, dhënia e kartës me të drejtat duhet t’u jepet shtetasve që në momentin e parë të shoqërimit në mjediset e policisë, pasi kur ata kalojnë në dhomat e sigurisë është një detyrim ligjor sikurse përcaktohet në nenin 34/a të K.Pr.Penale.

Në korridorin e dhomave të shoqërimit përveç posterave me të drejtat e personave të shoqëruar dhe atyre të ndaluar/arrestuar, **nuk** ishin të afishuara edhe lista e avokatëve mbrojtës me numrat e kontaktit të tyre, si dhe numrat e telefonit të Avokatit të Popullit dhe OJQ/OJF në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, të cilat janë pa pagesë.

Në ambientin e shoqërimit, **nuk** kishte dhomë më vehte për marrjen në pyetje të të shoqëruarve nga specialistët e policisë, sikurse përcaktohet në procedurën standarde të punës<sup>5</sup>. Intervistimi dhe marrja në pyetje e personave të shoqëruar kryhej në zyrat e punonjësve të policisë. Nga inspektimi i zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende të paligjshme apo që të ekspozojnë dhunë te personat e shoqëruar.

Mjediset e komisariatit dhe ambientet e shoqërimit **nuk** ishin të monitoruara nga sistemi i kamerave të sigurisë. Ky sistem do të mundësonte mbajtjen në vëzhgim të korridorit të godinës, si dhe të korridorit dhe hyrjes në dhomat e shoqërimit. Në vlerësimin e

---

<sup>3</sup> Kreu VI, pika 4 e procedurës standarde “*e.6.1 Përmasat e dyerve janë jo më pak se 1.0 x 2.0 m, prej materiali druri masiv të fortë dhe të staxhionuara (jo prej materiali fibër, kartonë apo tamburatë).*

*e.6.2 Dyert e dhomave të shoqërimit për të rriturit nga ana e brendshme përfordohen me një fletë llamarinë e cila montohet dhe puthitet me sipërfaqen e drurit të derës duke eliminuar/fshehur tehet prerës të saj.”*

<sup>4</sup> Raporti i CPT nga vizita inspektuese në vitin 2018 në Shqipëri thuhet shprehimisht se: “Sigurohuni që personat e arrestuar/arrestuar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre **nga fillimi i privimit të tyre nga liria**, duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë në fillim të ndalimit ose arrestimit. Personave të arrestuar/ndaluar duhet t’u jepet dhe të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se kanë marrë një kopje të fletës me të drejtat e tyre”.

<sup>5</sup> Kreu VI, pika 4/I e procedurës standarde, thuhet shprehimisht se: “Pranë dhomave të shoqërimit dhe pjesë të këtij sistemi projektohen dhe ndërtohen ambiente të posaçme: **Dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/ komisariatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen).**

institucionit të Avokatit të Popullit, vendosja e kamerave të sigurisë në komisariate, përveçse është një masë sigurie shtesë në këto institucione, përbën një element të rëndësishëm në parandalimin e veprimeve të kundraligjshme të punonjësve të policisë apo të ushtrimit të dhunës ndaj personave që ndodhen në cilësinë e të shoqëruarit, të arrestuarit dhe të ndaluarit në mjediset e policisë, si dhe kundërveprimet e tyre ndaj punonjësve të policisë.

Në momentin e inspektimit, në dhomat e shoqërimit nuk ndodhej asnjë person në cilësinë e të shoqëruarit, sipas përcaktimit në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Nga verifikimi i regjistrit për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar për periudhën Janar–Nëntor 2023, ishin shoqëruar në këto mjedise 150 persona në moshë madhore dhe 17 të mitur në konflikt me ligjin. Të dhënat e këtyre personave, ishin të evidentuara më vehte në regjistrat përkatës.

Nga ambientin e shoqërimit dhe zyrat e punës të punonjësve të policisë, nuk u konstatuan sende apo mjete që të ekspozonin dhunë psikologjike te personat e shoqëruar, gjatë marrjes në pyetje nga specialistët apo ndihmës specialistët e policisë.

Nga inspektimi u evidentua një problematikë, që kishte të bënte me ambientin ku ishin krijuar dhomat e shoqërimit. Dhomat të cilat ishin përshtatur si dhoma shoqërimi, më parë kanë qenë si ambiente të paraburgimit deri në vitin 2005 në varësi të Komisarariatit të Policisë, deri në ndërtimin më vehte të IEVP Tropojë. Nga këqyrja, ky ambient ishte i ndarë në dy pjesë që ndaheshin në mes me një derë hekuri dhe zgarë, që mbyllej nga jashtë me shul dhe çelës. Në njërin anë ndodheshin dy dhoma (të cilat ishin përshtatur si dhoma shoqërimi), ndërsa në anën tjetër ndodheshin dhomat e paraburgimit. Sipas informacionit të drejtuesve të komisarariatit, ato ambiente kanë qenë jashtë funksionit dhe nuk janë përdorur për asnjë qëllim. Por, grupi i inspektimit konstatoi se, dera e hekurit që ndante dhomat e shoqërimit nga dhomat e ish-paraburgimit ishte e hapur, pa çelës dhe pa vulosur. Në këto kushte, pavarësisht se ato janë ambiente që nuk përdoren, ekspozimi i tyre mund të përbëjnë shkak për presion apo dhunë psikologjike ndaj personave të shoqëruar që qëndrojnë në dhomat e shoqërimit. Me qëllim parandalimin e çdo veprimi apo tentative për dhunë dhe trajtim jo dinjitoz të personave të shoqëruar, me urdhër të shefit të komisarariatit, dhomat e ish-paraburgimit duhet të mbyllen menjëherë me çelës dhe të vulosen nga jashtë, procedurë e cila duhet të pasqyrohet në një procesverbal të firmosur nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim.

#### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre.**

Ambienti i sigurisë në Komisariatin e Policisë Tropojë ishte i mbyllur prej datës 1 shkurt 2023, menjëherë pas implementimit të Hartës së re Gjyqësore, që solli si rrjedhojë mbylljen e Gjykatës dhe Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Në këto kushte, personat e arrestuar apo të ndaluar nga punonjësit e policisë të këtij komisaritati, në përfundim të procedurave hetimore nga specialistët e policisë dhe pajisjen

me dokumentacion sipas kërkesave të parashikuara në K.Pr.Penale, dërgohen në dhomat e sigurisë të DVP Kukës.

Ambienti i sigurisë në këtë komisariat ndodhet në katin e parë të ndërtesës dhe ishte i mbyllur me çelës dhe në gjendje të mirë teknike, në pritje të një vendimmarrje nga organi epror (DVP Kukës), për shfrytëzimin e këtij ambienti për qëllime të tjera pune sipas funksioneve dhe nevojave të komisariatit.

Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, **ambienti i sigurisë në Komisaratin e Policisë Tropojë mund të përshtatet menjëherë në ambient shoqërimi**, sipas normave dhe parametrave të parashikuara në procedurën standarde të punës, duke bërë të mundur edhe mbylljen e dhomave të shoqërimit ekzistuese.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Nga inspektimi në Komisaratin e Policisë Tropojë, u evidentua se të dhënat për personat e shoqëruar, të arrestuar/ndaluar dhe për personat e mitur, ishin të regjistruara në regjistra më vehte, “Regjistrin e Evidentimit të të Dhënave për Personat e Shoqëruar”, “Regjistrin e evidentimit të personave të arrestuar/ndaluar”, si dhe “Regjistrin e Evidentimit të të Dhënave për Personat e Shoqëruar të Mitur (14 – 18 vjeç)”.

Nga verifikimi i dokumentacionit, regjistri i të shoqëruarve rezultoi se ishte sipas “Lidhja model 1”, të procedurës standarde të punës, i protokolluar dhe i sekretuar. Rubrikat e regjistrin ishin plotësuar përgjithësisht në mënyrë korrekte nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit<sup>6</sup>, por nga këqyrja e rubrikave, shënimet për njoftimin e familjarëve të të shoqëruarve me emrin e familjarit, numrin e telefonit dhe orën e njoftimit **nuk** ishin shënuar rregullisht për të gjithë personat e shoqëruar. Ndërkohë, koha e qëndrimit të shtetasve në dhomat e shoqërimit, ishte e ndryshme nga 1 deri në 4 orë, por jo më shumë se 10-12 orë në rastet e veçanta, në varësi të rezultatit të hetimit që kryejnë specialistët e policisë për veprën penale që dyshohen personat e shoqëruar.

Në këtë komisariat, pavarësisht se nuk ka dhoma sigurie, në zyrën e informacionit mbahej dhe ishte i plotësuar sipas rubrikave, regjistri për evidentimin e të dhënave të personave të ndaluar/arrestuar. Nga këqyrja e regjistrin dhe nga informacioni i drejtuesve të komisariatit rezultoi se, në rastet e arrestimeve në flagrancë, ora e arrestimit e shënuar në procesverbalin e arrestimit, si dhe ora e shënuar në regjistrin e të dhënave të personave të arrestuar/ndaluar që transferohen për në dhomat e sigurisë në Komisaratin e Policisë Kukës, përputhet me orën e shoqërimit të tyre që në momentin e hyrjes në mjedisin e Komisaratin të Policisë Tropojë.

---

<sup>6</sup> *Kreu VII, pika 1.2 e procedurës standarde të punës “Rregullat e trajtimit të të shoqëruarve në mjediset e policisë”, thuhet se: “Të dhënat për realizimin e të drejtës për njoftimin e familjarëve/afërmeve për shoqërimin si: emri, atësia, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që është njoftuar për faktin e shoqërimit dhe të vend ndodhjes së personit të shoqëruar, si dhe orën e njoftimit”.*

Nga verifikimi i regjistrave, në zyrën e informacionit ndodhej edhe regjistri për evidentimin e të dhënave për personat e shoqëruar të mitur. Ky regjistër ishte i sekretuar dhe i plotësuar sipas rubrikave.

Grupi i inspektimi konstatoi se, në ambientin e shoqërimit të komisariatit, **nuk** kishte një regjistër më vehte për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar. Në nenin 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, thuhet shprehimisht se: *“Çdo person i shoqëruar, i ndaluar apo i arrestuar në ambientet e policisë si dhe çdo shtetas tjetër, ndaj të cilit punonjësit e policisë, kryejnë veprime sipas dispozitave të këtij ligji ose që cenohen gjatë kryerjes së këtyre veprimeve, ka të drejtë t’u paraqesë kërkesë/ankesë me gojë ose me shkrim drejtuesve të policisë apo institucioneve të tjera shtetërore.....Punonjësi i policisë, pasi e ka regjistruar kërkesën/ankesën, e dokumenton në regjistrin përkatës dhe është i detyruar ta dërgojë menjëherë atë në institucionin të cilit i adresohet ankesa”*.

Regjistri për evidentimin e kërkesë/ankesave, është detyrim ligjor për çdo organ të policisë së shtetit, ndaj mungesa e tij përbën shkelje të kërkesave të ligjit. Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, mungesa e regjistrit të kërkesë/ankesave përbën shkelje të së drejtës që gëzon çdo person që shoqërohet, arrestohet apo ndalohet në mjediset e komisariatit, për t’u informuar për të drejtat e tyre, gjatë kohës së qëndrimit në këto mjedise. Strukturat e policisë, kanë detyrimin ligjor të evidentojnë në një regjistër të veçantë çdo kërkesë apo ankesë të shtetasve, si dhe të kthejnë përgjigje verbale ose me shkrim, për plotësimin apo refuzimin e kërkesës/ ankesës së tij, duke bërë shënime në regjistër. E drejta e shtetasve konsiderohet e plotësuar, kur sipas rasteve të parashikuara në ligj atyre iu krijohet mundësia t’i drejtohen edhe gjykatës në çdo kohë në lidhje me arsyet e refuzimit të kërkesës apo ankesës së paraqitur.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se, në mungesë të regjistrit të kërkesë/ankesave, në librin e shërbimit të punonjësve të policisë **nuk** kishte shënime për kërkesa nga personat e shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar në lidhje me njoftimin e familjarëve për shoqërimin, kërkesa për arsye të ndryshme shëndetësore apo për sigurimin e avokatëve mbrojtës nga lista e miratuar nga organi i prokurorisë, kërkesa të cilat janë prezente në të gjitha rastet e shoqërimit, por që duhet domosdoshmërisht të jenë të evidentuara në librat dhe regjistrat që administrohen nga komisariati i policisë.

Në vlerësimin tonë, mangësitë e konstatuara nuk janë për shkak se mungojnë aktet që normojnë dhe përcaktojnë rregullat për trajtimin e e personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar në mjediset e policisë, por vijnë më së shumti si neglizhencë e personelit të policisë që kryejnë shërbimin në këto ambiente, si dhe njëkohësisht për mungesë të ushtrimit të kontrollit periodik që duhet të kryejnë drejtuesit e komisariatit dhe të sektorëve që mbulojnë dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë. Kujtojmë gjithashtu se, neni 28 i Kushtetutës së RSH përcakton qartë se personit që i hiqet liria ka të drejtë t’u jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij, si dhe e drejta e trajtimit njerëzor dhe respektimit të dinjitetit të tij, ndaj në këto kushte zbatimi i kuadrit normativ nga strukturat dhe punonjësit e policisë, duhet të garantojnë zbatimin efektiv të ligjeve, por edhe plotësimin e gjithë të drejtave që gëzojnë këta persona.

## **Ambientet e intervistimit**

Nga inspektimi u evidentua se, në Komisarariat e Policisë Tropojë **nuk** ka dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen).

Procedura standarde e punës “Rregullat e trajtimit të të shoqëruarve në mjediset e policisë”, përcakton qartë kushtet që duhet të plotësojë dhoma e intervistimit apo marrjes në pyetje, e cila duhet të jetë e pajisur me tavolinë pune dhe karrige për oficerin e policisë gjyqësore, si dhe të ketë të instaluar pajisje elektronike për dokumentimin e veprimeve procedurale që kryhen nga OPGJ (kompjuter, printer, letër, etj). Gjithashtu, ajo duhet të jetë e kompletuar me tavolinë pune dhe dy karrige për qëndrimin e avokatit mbrojtës dhe të personit të dyshuar/akuzuar i cili do të intervistohet, arrestohet/ndalohet. Kjo dhomë, duhet të ketë të instaluar gjithashtu edhe sisteme dhe pajisje për **regjistrimin elektronik audio dhe video** të të gjitha veprimeve procedurale që kryhen me personin e shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore, para se personi të akomodohet në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit<sup>7</sup>.

Nga informacioni i drejtuesve të komisarariatit, mungon gjithashtu edhe dhoma për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të mitur. Marrja në pyetje e të miturve (14-18 vjeç), kryhet në zyrat e punonjësve të policisë, në prezencë të kujdestarit ligjor, psikologut dhe avokatit mbrojtës, të cilat gjithashtu nuk janë të monitoruara nga sisteme të kamerave audio-vizive. Për periudhën Janar - Nëntor 2023, në regjistrin për të mitur ishin regjistruar 17 të mitur, sipas procedurave të parashikuara në Kodin e Drejtësisë për të Miturit dhe procedurën standarde.

Dokumentet kryesore mbi të cilat bazohen rregullat dhe procedurat që duhet të zbatohen strukturat dhe punonjësit e policisë në nivel vendor, me qëllim garantimin e të drejtave të shtetasve në mjediset e policisë, përcaktojnë qartë detyrimin për drejtoritë/komisariatet e policisë, për krijimin brenda ambienteve të tyre, të një ambienti të veçantë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave që shoqërohen në mjediset e tyre, në cilësinë e të shoqëruarit apo të arrestuarit të dyshuar për kryerjen e një veprë penale.

Avokati i Popullit e konsideron një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut krijimin e ambienteve të intervistimit, si dhe vendosjen e sistemit të kamerave audio-vizive në komisarariatet e policisë, pasi ato kanë efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit, ndaj tyre.

## **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Nga informacioni, si dhe nga intervistat me specialistët dhe punonjësit e policisë në zyrën e informacionit, rezultoi se zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe kreu VII, pika a.3.4 të e

---

<sup>7</sup> Kreu VI, pika 4/i 1.1 e procedurës standarde të punës.



procedurës standarde të punës, që ka të bëjë me plotësimin e procesverbalit mbi veprimet e kryera me të shoqëruarit nga specialisti i policisë që është i ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse dhe në përfundim, një kopje e këtij procesverbali i jepet personit të shoqëruar.

Grupi i inspektimit kontrolloi dosjen me fashikuj që ndodhej në zyrën e informacionit, nga ku rezultoi se ndodhej “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”, si dhe një kopje e procerverbalit të shoqërimit, të cilët ishin të plotësuar sipas rubrikave dhe të firmosur nga punonjësi i policisë që kishte trajtuar çështjen dhe nga personi i shoqëruar. U evidentua se, në asnjërën prej këtyre dokumenteve, të shoqëruarit nuk kishin shfaqur ankesa apo pretendime për keqtrajtim nga punonjësit e policisë që kishin kryer veprime procedurale me këta persona.

Në të gjitha rastet e lëshimit të urdhërave për arrestimin apo ndalimin e personave në dhomat e sigurisë, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b pika 2 dhe 251 të K.Pr.P, ku thuhet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vehte një kopje të letrës me të drejtat që gëzojnë këta persona dhe kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Nga grupi i inspektimit, në mungesë të të shoqëruarve, u zhvilluan intervista me punonjësit e policisë që kryejnë shërbim në ambientet e privimit të lirisë. Nga intervistat u evidentua se, punonjësit e policisë zbatonin detyrimin ligjor për t’i informuar personat e shoqëruar apo të ndaluar/arrestuar, që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat mbrojtës, mund të kërkojë ndihmë juridike falas dhe t’u ofrohet një avokat mbrojtës kryesisht, nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në ish-zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë.

Gjithashtu nga intervistat me punonjësit e policisë u evidentua se, personat e shoqëruar në mjediset e policisë njiheshin verbalisht me të drejtat e tyre, po atyre nuk u jepej letra me të drejtat që në momentin e hyrjes së tyre në ambientet e komisariatit. E njëjta praktikë ndiqej edhe për shtetasit e huaj që shoqërohen në mjediset e komisariatit, pavarësisht se karta e të drejtave ishte e përkthyer në disa nga gjuhët e huaja kryesore.

E drejta për informim e personave që shoqërohen në mjediset e policisë së shtetit, është një e drejtë thelbësore për çdo shtetas vendas apo të huaj. Theks të veçantë për këtë çështje, ka venë dhe KPT (Komiteti European për Parandalimin e Torturës) gjatë vizitës së tij të fundit në Shqipëri në vitin 2018, ku në raportin drejtuar autoriteteve të shtetit shqipëtar, ka rekomanduar: *“Sigurohuni që personat e arrestuar/arrestuar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të tyre nga liria, duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë në fillim të arrestimit ose arrestimit”*<sup>8</sup>.

---

<sup>8</sup> CPT ka bërë publik në datën 17.09.2019, raportin mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 Nëntor 2018.  
<https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet proceduriale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës, kujdestarit ligjor dhe psikologut. Psikologu sigurohej nga komisarati i policisë në bashkëpunim me Bashkinë dhe shkollat e mesme të qytetit të Tropojës. Nga këqyrja e regjistrit për të miturit, nuk kishte patur raste të shoqërimit të tyre në mjediset e komisarariatit gjatë këtij viti.

Në rastin kur personat e shoqëruar shfaqnin probleme shëndetësore dhe kërkonin ndihmë mjekësore, punonjësit e policisë me miratimin e kërkesës nga shefi i komisarariatit, bënë shoqërimin e personit menjëherë për në Spitalin Rajonal të qytetit. Rezultatet e kontrollit mjekësor pasqyroheshin në një regjister të veçantë të vizitave mjekësore.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

### **REKOMANDOJMË:**

1. Të merren masa të menjëhershme nga strukturat përgjegjëse në DVP Kukës dhe Komisaratin e Policisë Tropojë, për përshtatjen dhe adoptimin e dhomave ekzistuese të sigurisë dhe kthimin në dhoma shoqërimi, sipas normave dhe parametrave të parashikuara në procedurën standarde të punës *“Rregullat e trajtimit të të shoqëruarve në mjediset e policisë”*.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për mbylljen me çelës dhe vulosjen e ish-ambienteve të paraburgimit, kundrejt procesverbalit të firmosur nga një komision i krijuar me urdhër të brendshëm të shefit të komisarariatit.
3. Të merren masa të menjëhershme, për vendosjen në ambientin e shoqërimit të regjistrit për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të privuar nga liria, si dhe trajtimin dhe zgjidhjen efektive të tyre, nga strukturat dhe punonjësit e policisë në këtë komisarariat.
4. Të merren masat e menjëhershme, për krijimin e një dhome të veçantë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, kryesisht të personave të mitur, para se të dërgohen në ambientin e sigurisë.
5. Të merren masat e nevojshme, për pajisjen e dhomave ekzistuese të shoqërimit me orenditë e nevojshme si tavolina pune për specialistët e policisë, si dhe karrige (stola) për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar, me këmbë të fiksuara në mënyrë të palëvizshme në dysheme.
6. Të merren masat e nevojshme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera sigurie në ambientin e shoqërimit dhe në dhomat ku merren në pyetje personat e shoqëruar të dyshuar për kryerjen e veprave penale.

7. Të merren masa të menjëhershme, për dhënien e kartës me të drejtat për shtetasit që nga fillimi i privimit të lirisë së tyre, në cilësinë e personave të shoqëruarve apo të arretuar, në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaj.
8. Të merren masa të menjëhershme, për afishimin në korridorin e dhomave të shoqërimit dhe brenda tyre, të posterave me të drejtat e personave të shoqëruar dhe atyre të ndaluar/arrestuar, listës së avokatëve mbrojtës me numrat e kontaktit të tyre, si dhe të numrave të telefonit të Avokatit të Popullit dhe OJQ/OJF për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
9. Të merren masa e menjëhershme, për organizimin e trajnimeve të punonjësve të policisë në lidhje me zbatimin e rregullave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe standardet ndërkombëtare, me qëllim garantimin efektiv të të drejtave të personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar në mjediset e komisariatit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ahmet PRENÇI**